





SI TË APLIKOSH PËR **LEJE INFRASTRUKTURE** PRANË BASHKISË SHKODËR

UDHËZUES PËR QYTETARËT DHE PROFESIONISTËT





Udhëzuesi për profesionistët dhe qytetarët:
“Aplikimi për Leje Infrastruktura”.

AUTOR

Drejtorja e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

UDHËHEQËS TË PROCESIT:

Robert Piro, Drejtor

Drejtorja e kontrollit të zhvillimit të territorit

Grupi i punës:

Drejtorja e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit

Arion Omi, Elsedra Zmiani, Najda Rroji, Valter Laloshi,
Xhevahir Heta.

BASHKIA SHKODËR

Shkodër, 2025



SHËNIM I RËNDËSISHËM

Roli i këtij udhëzuesi është orientues për mënyrën e aplikimit të Lejes së Infrastruktura.

Sugjerimet e dhëna në këtë udhëzues nuk janë shteruese, pasi vetë rastet e aplikimit për Leje Infrastruktura janë nga më të ndryshmet dhe trajtimet e tyre nuk janë standarte.

Referencat ligjore të cituara në këtë udhëzues i përkasin kohës së përgatitjes së tij, prandaj çdo përdorues i këtij udhëzuesi duhet të jetë i kujdesshëm t'i referohet bazës ligjore të përditësuar nga burimet zyrtare në momentin e përdorimit të tij.







TABELA E PËRMAJTJES

1. Hyrja	Faqe 1
2. Cfarë është leja e infrastrukturës	Faqe 1
3. Punime për të cilat kërkohet pajisja me leje infrastrukturë	Faqe 1
4. Mënyra e aplikimit	Faqe 2
5. Dokumentacioni tekniko-ligjor për aplikim online	Faqe 3-4
6. Ngarkimi elektronik i dokumentave	Faqe 5
7. Koha e nevojshme për marrjen e shërbimit	Faqe 5
8. Periudha e vlefshmërisë	Faqe 5
9. Baza ligjore	Faqe 6



HYRJA

MATERIALI "Aplikim për Leje Ndërtimi Infrastruktura" i vjen në ndihmë profesionistëve të fushës si dhe të interesuarve që aplikojnë për leje ndërtimi infrastrukture duke i udhëzuar për bazën ligjore dhe dokumentacionin e nevojshëm për pajisjen me leje.



CFARE ËSHTË LEJA E INFRASTRUKTURËS?

"Leje ndërtimi infrastrukture" është akti i miratimit të kërkesës për leje ndërtimi dhe i lejimit të punimeve"



PUNIME PËR TË CILAT KËRKOHET PAJISJA ME LEJE INFRASTRUKTURE

Rezultojnë në ngritje rrjetesh shërbimi ose sigurie publike, të rrjetit elektrik, rrjeteve të ujësjellësit, të kanalizimit, të ngrohjes, të telefonisë, të internetit, të kanaleve të kullimit apo të kanaleve të ujitjes, leje të rrjeteve rrugore dhe të sinjalistikës rrugore nga subjektet publike ose private, sipas legjislacionit në fuqi

> MËNYRA E APLIKIMIT

Çdo subjekt, i cili kërkon të pajiset me leje infrastrukture, është i detyruar të dorëzojë aplikimin për leje dhe dokumentacionin shoqërues nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve.

Sistemi elektronik i lejeve shërben si pika e vetme, nëpërmjet të cilit:

- paraqitet, elektronikisht, kërkesa për leje, sipas legjislacionit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- komunikohen vendimet institucionale për kërkesan
- njoftohen aplikuesit lidhur me statusin e kërkesave të tyre


Aplikimi për leje ndërtimi infrastrukture kryhet nëpërmjet portalit online E-LEJE pjesë e platformës E-ALBANIA.



> Shënim:

Aplikimi për lejen e infrastrukturës dhe manualin e përdorimit të platformës e-albania, mund të aksesoni në faqen WEB:

www.ealbania.com




DOKUMENTACIONI TEKNIKO-LIGJOR PËR APLIKIM ONLINE

1. **KËRKESA PËR LEJE INFRASTRUKTURE**, sipas formatit të aplikimit, të përcaktuar në sistemin elektronik të lejeve;
2. **PROKURA OSE AUTORIZIMI**, në emër të personit fizik apo juridik, në rast se kërkesa paraqitet nga një përfaqësues i pronarit ose zhvilluesit;
3. **DOKUMENTE QË VËRTETOJNË TË DREJTAT PASURORE TË PRONËS/AVE** që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta;
4. **PLANI I VENDOSJES SË NDËRTIMIT** mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese;
5. **PROJEKTI I NDËRTIMIT DHE RELACIONI PËRKATËS** të nënshkruar elektronikisht në format pdf dhe dwg.
6. **GRAFIKU PARAPRAK I PUNIMEVE DHE AFATI I PËRFUNDIMIT TË OBJEKTIT**, SIPAS FAZAVE TË ZBATIMIT,
7. **PREVENTIVI**;
8. **LEJET, LICENCAT, AUTORIZIMET APO AKTET E MIRATIMIT, TË NEVOJSHME PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT**, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes;

> **Shënim:**

Në projekt duhet të evidentohet të gjitha pasuritë e prekura nga zhvillimi dhe kufinjte e tyre; si dhe statusi juridik lëshuar nga ASHK për të gjithë pasuritë që preken nga zhvillimi.





DOKUMENTACIONI TEKNIKO-LIGJOR PËR APLIKIM ONLINE

9. DEKLARATA E PROJEKTUESIT TË LICENCUAR, sipas formatit të aplikimit.

10. MANDATPAGESËN/AT E TARIFËS/AVE TË APLIKIMIT;

11. KOPJE E PËLICËS SË SIGURIMIT TË PROJEKTUESVE, për mbulimin e përgjegjësisë profesionale (Për projektin në fjalë);

12. STUDIMI GJEOLLOJIK në rast se parashikohet;

13. OPONENCË TEKNIKE për të gjitha:

- ndërtimet publike;
- ndërtime jo publike, me vlerë të prejetivuar së paku 100 (njëqind milion) lekë;


14. VNM, në rastet kur është e detyrueshme në bazë të ligjit nr.10440, datë 11.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, i ndryshuar.

15. MIRATIMI I PROJEKTIT NGA INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE (IKTK), në rastet e parashikuara në legjislacionin e trashëgimisë kulturore.

> Shënim:

Në projekt duhet të evidentohet të gjitha pasuritë e prekura nga zhvillimi dhe kufijtë e tyre; si dhe statusi juridik lëshuar nga ASHK për të gjithë pasuritë që preken nga zhvillimi.





NGARKIMI ELEKTRONIK I DOKUMENTAVE

Kërkesa për Leje Ndërtimi Infrastruktura paraqitet për shqyrtim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, i cili mundëson ngarkimin elektronik të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për leje ndërtimi.



KOHA E NEVOJSHME PËR MARRJEN E SHERBIMIT

Brenda 60 ditëve punë nga data e dorëzimit të aplikimit për leje infrastrukturë lëshohet leja e infrastrukturës.




PERIUDHA E VLEFSHMËRISË

Sipas afateve të përcaktuar në formularin e lejes së infrastrukturës.

> Shënim:

Lutemi të skanoni të gjitha dokumentat e listuara të cilat do ngarkoni në sistem.



➤ BAZA LIGJORE

1. LIGJ NR. 107/2014 PËR PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E TERRITORIT
2. LIGJ NR. 124/2015 PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË
3. LIGJ NR.10 440, DATË 7.7. 2011 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS
4. LIGJI NR. 81/2017 PËR ZONAT E MBROJTURA
5. LIGJ NR. 27/2018 PËR TRASHËGIMINË KULTURORE DHE MUZETË
6. L I G J NR.8402, DATE 10.9.1998 PER KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TE NDERTIMIT
7. VENDIM NR. 408, DATË 13.5.2015 PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
8. VENDIM NR. 430, DATË 11.7.2018 PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE PËR SISTEMIN ELEKTRONIK TË LEJEVE (ELEJE)
9. VENDIM NR. 537, DATË 8.7.2020 PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE MINIMALE TË PERFORMANCËS SË ENERGJISË SË NDËRTESAVE DHE TË ELEMENTEVE TË NDËRTESAVE
10. VENDIM NR. 283, DATË 1.4.2015 “PËR PËRCAKTIMIN E TIPAVE, RREGULLAVE, KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE PËR PRODHIMIN, RUAJTJEN DHE PËRPUNIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE BLEGTORALE, NË TOKË BUJQËSORE”
11. VENDIM NR.1124, DATË 30.7.2008 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE, TË PROCEDURAVE DHE KRITEREVE PËR PAJISJEN ME CERTIFIKATËN E SPECIALISTIT PËR 12. VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS DHE AUDITIMIN MJEDISOR”
12. VENDIM NR. 9, DATË 11.1.2024 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PROJEKTET QË DUHET T’I NËNSHTROHEN OPONENCËS TEKNIKE SIPAS SECILËS FUSHË PROJEKTIMI, SI DHE PROCEDURAT QË NDIQEN NË KËTO RASTE

➤ Shënim:

Referencat ligjore të cituara në këtë udhëzues i përkasin kohës së përgatitjes së tij, prandaj çdo përdorues i këtij udhëzuesi duhet të jetë i kujdesshëm t’i referohet bazës ligjore të përditësuar nga burimet zyrtare në momentin e përdorimit të tij.

Udhëzuesi “Si të aplikosh për Leje Infrastruktura”,
është pjesë e një pakete informative për zbatimin e bazës tekniko - ligjore sipas kushteve të
zhvillimit të përcaktuara në legjislacionin dhe rregulloret përkatëse në fuqi, së bashku me:

Udhëzuesin “Si të aplikosh për Leje Zhvillimi”

Udhëzuesin “Si të aplikosh për Leje Ndërtimi”

Udhëzuesin “Si të aplikosh për Çertifikatë përdorimi”

Udhëzuesin “Si të aplikosh për Deklaratë Paraprake për Kryerje Punimesh”

Përgatitur nga Bashkia Shkodër me mbështetje teknike të
Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

SHKODËR 2025

